**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna Kaçanik**
**Opština Kacanik**
**Municipality Kacanik**

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore
01Nr.111/01- 3979/21

**Komuna e Kaçanikut** në mbështetje të nenit 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publikë dhe nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik më datë 02.04.2021 rishpallë:

## KONKURS
## PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS NË SHËRBIMIN PUBLIK

**I.** Titulli i vendit të punës: **SPECIALIST I MJEKËSISË EMERGJENTE**
Numri i pozitave: **Një (1)**
Koeficienti/Grada:H-659/1
Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale
Njësia/sektori:Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dëshmoret e Lirisë"

**Përshkrimi i përgjithshëm i detyrave të punës**

1. Aplikimi i njohurive të reja dhe risive në diagnostifikim dhe mjekim të sëmundjeve
2. Kryen vizita shëndetësore në njësinë e urgjencës në QKMF dhe në teren
3. Ofron shërbime shëndetësore urgjente për pacientët e të gjitha moshave dhe ndërmerr masa terapeutike nga lëmia e mjekësisë emergjente si dhe i udhëzon për nivelin sekondar dhe terciar
4. Plotëson fletëzat kompjuterike si dhe të dhënat e tjera të pacientëve në të dhënat softuerike
5. Raportimi me kohë i sëmundjeve infektive dhe raportime tjera sipas kërkesës së menaxherëve
6. Merr pjesë në mbledhje, trajnime dhe aktivitete e ZHVP-së
7. Kryen edhe detyra tjera të pëcaktuara me legjislacionin në fuqi nga fusha e mjekësisë emergjente

**Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik janë:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për gjuhët, të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, të mos ketë në fuqi asnjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

**Përveç kushteve të përgjithshme të cekura më lartë kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa:**

- Diplomë universitare në Mjekësi- Specializimi në Mjekësi emergjente
- Të jetë i regjistruar dhe i licencuar
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësihulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, etj.)

**Kohëzgjatja e emërimit :** pa afat të caktuar
Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar, kati përdhesë dhe në web-faqen komunale

**Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 ditë duke filluar prej datës 03.05.2021 deri më 17.05.2021**

**<u>Së bashku me aplikacionin kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin si në vijim:</u>**

1. Kopjen e vërtetuar të Diplomës,
3. Kopja e letërnjoftimit, ekstrakin e lindjes, dëshminë se nuk është nën hetime
4. Dëshminë shëndetësore (pas përzgjedhjes )

Pas vlerësimit të kandidatëve Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore publikon listen e kandidatëve fitues në linkun https://konkursi.rks-gov.net/ dhe web-faqen komunale
"Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil dhe publik të Kosovës, siç specifikohet në Ligj";
"Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen";
Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vetdeklaron se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.